



DEMOKRACIA PARLAMENTARE



KOSOVA, SHTET DEMOKRATIK

RITA (9), ERISA (9), ELTRIS (9), BLEND (9), LEON (9), RINA (10), LIBURN (9)



Demokracia është një sistem i qeverisjes, ku vetë populli merr vendime për vendin e vet


Të jetosh i lirë në një vend, të kesh të drejtën e shprehjes e të mendimit, të jesh i barabartë me të tjerët do të thotë demokraci. Demokracia është formë e qeverisjes, ku pushtetin e ka në dorë vetë populli. Ajo është paraqitur në vitin 507 para erës sonë, por në atë kohë nuk ka qenë demokracia e mirëfilltë. Kemi dy forma të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë është formë e qeverisjes, ku vetë populli merr vendime për shtetin e vet. Ndërsa, demokracia përfaqësuese është kur qytetarët marrin vendime përmes përfaqësuesve të tyre që vetë populli i ka votuar. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: sistemi parlamentar dhe sistemi presidencial. Në sistemin parlamentar vendimet si përzgjedhja e Presidentit dhe miratimi i ligjeve bëhet nga Kuvendi, ndërsa në sistemi presidencial Presidenti i vendit zgjidhet me anë të votave të qytetarëve të vendi.

Ne sot e kemi nderin t'iu bëjmë disa pyetje dy personave shumë të rëndësishëm. Për z. Lukas, ne bëjmë pyetjen nëse Austria është shtet demokratik parlamentar apo presidencial. Ai na u përgjigj se Austria është shtet demokratik parlamentar. Kurse, z. Fridheim, e pyetëm nëse është e vështirë të jesh Ministër i një vendi dhe për sa vjet keni qenë Ministër? Në këtë pyetje i ftuari ynë u përgjigj:

„Unë kam qenë ministër për tre vjet me radhë. Ne e mbrojmë vendin tonë në të gjitha mënyrat, prandaj ndonjëherë është e vështirë ta bëjmë një gjë të tillë.“



Grupi punues i demokracisë



Në demokraci kemi të drejtë të shkollohemi

KANDIDATËT E ARDHSHËM

ANDI (9), ARRITA (9), LEURITA (9), DRIJON (10), ERA (9), ORGES (9), LEON (9), ANDI (9)

Ne jemi grupi „Rrushi“. Ne jemi klasa IV-5 dhe kemi mësuar për zgjedhjet si dhe kemi punuar bashkë në grup. Ne ju urojmë lexim të mbarë

Në procesin zgjedhor kanë të drejtë të marrin pjesë personat që i kanë më shumë se 18 vjet. Mund të marrin pjesë të gjithë njerëzit pa dallim feje, gjinie apo race. Sot morëm pjesë në procesin e votimit, dhe shkruam programin tonë me idetë tona për një vend më të mirë. Kemi shkruar për shtetin tonë, qytetarët dhe si të zgjedhim deputetin që ka dhënë ide të mrekullueshme. Partia që mori më së shumti vota ishte Vishnja dhe në vendin e dytë ishte Dredhëza. Programi i partisë Vishnja ishte: „Unë do të jem i mirë me njerëzit, do të bëjë bamirësi, do të ndërtoj ndërtesa. Çdo vend të prishur do ta rregullojë, do të ndërtojë shkolla, do t'i ndihmojë njerëzit të gjejnë punë, do të ndërtojë kopshte dhe fusha futbollli dhe parqe për të luajtur si vajzat ashtu edhe djemtë, do të ndërtojë su-

permarkete, vend për rroba, do të shpërndajë batanije për të varfërit, etj.“ Më poshtë mund të lexoni përgjigje e mysafirëve tanë. Ju faleminderit.




Sot gjatë procesit të votimit



Ambasadori sot na tregoi se votimi është shumë i rëndësishëm dhe se ka shumë dëshirë ta bëjë punën e tij për të ndihmuar Kosovën.

Ambasadori i Kosovës në Austri duke u përgjigjur



Unë jam shumë i gëzuar që u bëra deputet.


Deputeti i ardhshëm



Grupi duke e intervistuar ambasadorin, Zt. Sami Uckeli

KUVENDI - SHTËPIA E POPULLIT

BUNA (9), ERVIN (9), YLLI (9), LORESA (9), LUMI (9), ARSA (8), ARGJEND (9)



Sot kemi mësuar për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, kemi intervistuar dy deputetë të Kuvendit të Austrisë

Kuvendi përfaqëson popullin, ose më ndryshe Kuvendi është Shtëpia e Popullit, sepse ai miraton ose propozon ligjet. Kush i shkel ligjet duhet të gjykohej nga gjykata e pastaj edhe mund të dënohet me vite, me muaj, me ditë ose me javë. Kuvendi e miraton edhe

dhe ne ju kemi parashtruar disa pyetje. Në pyetjen se sa deputetë janë në Kuvendin e Austrisë, ata u përgjigjen se janë 183 deputetë. Ndërsa, në pyetjen tjetër për Z. Gerahad për përgjegjësitë e një deputeti në Kuvendin e Austrisë, ai u përgjigj se përgjegjësia e tyre është të punojnë shumë për të ardhmen e gjeneratave të reja. Pyetjet e fundit ishin për z. Baxant. Neve na interesonte nëse ai kishte propozuar ndonjëherë ligje dhe se a iu pëlqenin mysafirëve tanë profesionet e tyre. Përgjigja e Zt. Baxant ishte: „Po, kemi propozuar ligje, si për sport, muzikë, etj.“ Kurse, sa i përket profesionit ata thanë se detyra e tyre është të punojnë me shumë përgjegjësi, por më e rëndësishmja është t'i duan njerëzit dhe të kenë lidhje emocionale me ta. Ne jemi të kënaqur me përgjigjet që ata na kanë dhënë dhe gjithashtu kemi mësuar disa gjëra për deputetët e Kuvendit të Austrisë. Faleminderit për vëmendje!



buxhetin e shtetit. Nëse ndërtohet një shkollë, jepet buxheti për të, sepse është e drejta jonë themelore të shkollohemi. Kuvendi e voton edhe Presidentin e shtetit. Pjesë e Kuvendit është Kryetari, nënkryetarët dhe deputetët. Kosova, pra i ka pjesë të vetën Kuvendin, Qeverinë dhe gjykatat e saj. Në Kuvend janë gjithsej 120 deputetë, ku 100 prej tyre i takojnë qytetarëve shumicë dhe 20 të tjerë i takojnë komunitetit jo shumicë. Sot na vizituan disa deputetë të Kuvendit të Austrisë,



Gazetarët e vegjël

NE SI QYTETARË TË MIRË

LEONA (9), LABIAN (9), ONIDA (8), ELMEDINA (9), ERDA (9), FATLUMI (9), ALMIRI (9)



Autorët e artikullit

Mësoni për të drejtat dhe përgjegjësitë tona

Ne jemi qytetarë të Kosovës. Si qytetarë që jemi kemi të drejta dhe përgjegjësi. Disa nga të drejtat janë: të lozim, të shkollohemi, të punojmë, të shkruajmë, të lexojmë, të jemi të barabartë, të strehohemi, etj. Ndërkaq, përgjegjësitë tona janë: të pastrojmë, të mësojmë, të respektojmë njëri-tjetrin. Ne duhet të respektojmë mësuesen, njerëzit e mos-huar, etj. Vizitorja e ditës së sotme znj. Gabriela Moser nga Austria na tha se e rëndësishme është edhe ta respektojmë ligjin, për shembull duhet të jemi të kujdesshëm me mbeturinat që ato t'i vendosim në vendin e caktuar. Ndërkaq, vizitorja Monika Lemmer na tha që duhet të dalim të votojmë kur të mbushim 18 vjet, sepse kështu mund të jemi qytetarë të mirë.



Qytetaria aktive punuar nga ne



E drejta e shkollimit



E drejta e strehimit



Gratë dhe burrat janë të barabartë



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Faik Konica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IV-5
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë